

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË
Vendimi Nr 1120



PËR REGJISTRIMIN E QENDRES "QENDRESA QYTETARE"

Në Tiranë, sot më datë 15.09.2016 unë gjyqtari Z. Celikel
Në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur prej Z.Rigels Xhemollari, në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të Qendrës "QENDRESA QYTETARE" dhe

KONSTATOVA

Se është themeluar më datë 01.10.2015 një organizatë jofitimprurëse e titulluar Qendra "QENDRESA QYTETARE".
Anëtar themelues i saj është: Z.Rigels Xhemollari lindur më 13/11/1987 në Pogradec dhe banues në Tiranë me nr.ID I71113063N, shtetas shqiptar.

Selia e Qendrës është në adresën: Sheshi "Avni Rustemi", Rruga "Hoxha Tahsim", Pall."Vjero", AP.A17/A, Tiranë.

Qëllimi dhe objektivat e Qendrës janë:

Qëllimi i qendrës është të mbrojmë dinjitetin dhe personalitetin njerëzor dhe të forcojmë qytetarinë nëpërmjet depolitizimit, orientimit drejt iniciativës së lirë, promovimit të biznesit dhe kreativitetit rinor, rritjes së vigjilencës së konsumatorit, rritjes së ndërgjegjes kombëtare dhe orientimit drejt një arsimit cilësor.

Objektivat:

Forcimi komuniteteve qytetare në lagje, shkolla dhe njësi administrative
Advokimi për një shërbim publik dinjitoz ndaj qytetarit
Mbrojtja e Konsumatorit bazuar në Strategjitë kombëtare dhe ligjet në fuqi
Rritja e ndërgjegjes kombëtare dhe promovimi i një sistemi arsimor cilësor
Mbrojtja nga diskriminimi dhe dhuna në institucionet publike dhe familje

Organet drejtuese dhe ekzekutive të Qendrës janë:

Bordi Drejtues

Organi më i lartë i Qendrës është Bordi Drejtues që mblidhet të paktën katër herë në vit.
Ne mbledhjen e themelimit si Drejtor Ekzekutiv i saj u zgjodh Rigës XHEMOLLARI, i cili është i autorizuar të ndjeke procedurat e nevojshme për regjistrimin e organizatës dhe përfaqësimin e saj me të tretët.

Drejtori Ekzekutiv

Drejtori Ekzekutiv zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve për një mandat 3- vjeçar me të drejtë ri-mandatimi. Ai e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Statutin dhe Aktin e Themelimit.

BURIMET FINANCIARE

Burimet financiare të qendrës janë si më poshtë:

- Donacione ose sponsorizime private ose nga individë, institucione qeveritare dhe joqeveritare, vendase ose të huaja që do të mbështesin realizimin e qëllimit të qendrës.
- Të ardhura nga pasuri të luajshme dhe të paluajshme në përputhje me legjislacionin ekzistues.
- Kontribute nga themeluesit.
- Të ardhura nga aktiviteti ekonomik jofitimprurës apo administrimi i pasurive

PËR KËTË ARSYE

Duke u mbështetur në ligjin N.8788 datë 07.01.2001 " Për organizatat jofitimprurëse në Republikën e Shqipërisë" si dhe në mbështetje të nenit 39-53 të Kodit Civil dhe ligjit N.8781 datë 03.05.2002

VENDOSA

Pranimin e kërkesës

Të regjistroj si Person Juridik organizatën jofitimprurëse "QENDRESA QYTETARE".

Selia qendrore e qendrës do të jetë: Sheshi "Avni Rustemi" , Rruga "Hoxha Tahsim", Pall."Vjero", AP.A17/A, Tiranë.

Qëllimet dhe objektivat e qendrës do të jenë:

Qëllimi i qendrës është të mbrojmë dinjitetin dhe personalitetin njerëzor dhe të forcojmë qytetarinë nëpërmjet depolitizimit, orientimit drejt iniciativës së lirë, promovimit të biznesit dhe kreativitetit rinor, rritjes së vigjilencës së konsumatorit, rritjes së ndërgjegjes kombëtare dhe orientimit drejt një arsimit cilësor.

Objektivat:

- Forcimi komuniteteve qytetare në lagje, shkollë dhe njësi administrative
- Advokimi për një shërbim publik dinjitoz ndaj qytetarit
- Mbrojtja e Konsumatorit bazuar në Strategjitë kombëtare dhe ligjet në fuqi
- Rritja e ndërgjegjes kombëtare dhe promovimi i një sistemi arsimor cilësor
- Mbrojtja nga diskriminimi dhe dhuna në institucionet publike dhe familje



Organet drejtuese dhe ekzekutive të Qendrës janë:

Bordi Drejtues

Organi më i lartë vendimmarrës i Qendrës është Bordi Drejtues. Bordi përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët zgjidhen çdo 3 vjet me votim. Anëtarët e bordit të parë drejtues janë: Rigels Xhemollari, Ines Mulellari, Altin Collaku, Migel Zallemi dhe Valmira Kosova.

Drejtori Ekzekutiv

Organi më i lartë ekzekutiv i Qendrës është Drejtori Ekzekutiv. Drejtori Ekzekutiv zgjidhet nga Bordi Drejtues për një mandat 3-vjeçar me të drejtë ri-mandatimi. Drejtor Ekzekutiv u zgjodh Rigels Xhemollari.

U Shpall sot më datë 15/09/2016

GJYQTARI





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË**

Nr. 1120/1 Vendimi

**V E N D I M
PËR DEPOZITIM AKTESH**

Sot më datë 22.07.2019, unë Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë **Neritan CENA**, mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga kërkuesi Rigels Xhemollari në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të Qendrës “Qëndresa Qytetare”, me anë të së cilës ka kërkuar : “Depozitimin e Vendimit nr. 3, datë 01.07.2019 të Bordit Drejtues të Qendrës “Qëndresa Qytetare”, dhe

K O N S T A T O V A

Se kërkuesi Rigels Xhemollari në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të Qendrës “Qëndresa Qytetare”, rezulton që t’i jetë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë me anë të së cilës ka kërkuar : “Depozitimin e Vendimit nr. 3, datë 01.07.2019 të Bordit Drejtues të Qendrës “Qëndresa Qytetare”, me anë të të cilit rezulton që të jetë vendosur :

“1. Të pranojë dorëheqjen nga Bordi Drejtues të znj. Ines Mulellari dhe z. Altin Çollaku në mbarim të mandatit të tyre dhe me vullnetin dhe zëvendësimin e tyre nga znj. Ogerta Ujkashi dhe znj. Kujtime Kotorri.

2. Bordi i ri Drejtues i Qendrës për periudhën 2019 – 2021 të jetë si më poshtë :

- Drejtor ekzekutiv Rigels Xhemollari.*
- Anëtar i Bordit Drejtues Kujtime Kotorri.*
- Anëtar i Bordit Drejtues Migel Zallemi.*
- Anëtar i Bordit Drejtues Ogerta Ujkashi.*
- Anëtar i Bordit Drejtues Valmira Kosova.*

3. Rigels Xhemollari të zgjidhet Drejtor Ekzekutiv me mandat për periudhën 2019 – 2021.

- Ky vendim të depozitohet nga Drejtori Ekzekutiv në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në Regjistrin Tregtar”.

Nga aktet që ndodhen në dosje rezulton që Qendra e emërtuar : “Q ëndresa Qytetare” rezulton që të jetë regjistruar si person juridik me vendimin nr. 1120, datë 15.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Referuar përmbajtjes së aktit të themelimit dhe statutit të Qendrës së emërtuar : “Qëndresa Qytetare” rezulton që vendimi i Bordit Drejtues të Qendrës “Qëndresa Qytetare” të jetë marrë në përputhje me dispozitat e përcaktuara në aktin e themelimit dhe në statutin e Qendrës “Qëndresa Qytetare”.

Nisur nga sa u parashtrua më lart, duke u bazuar në dokumentacionin e paraqitur, çmoj se kërkesa është e drejtë e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata në zbatim të Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jo Fitimprurëse” të ndryshuar dhe në zbatim të Ligjit nr. 8789 datë 07.05.2001 “Për Regjistrimin e Organizatave Jo Fitimprurëse”

V E N D O S I

- Pranimin e kërkesës së kërkuarit Rigels Xhemollari.
- Depozitimin e Vendimit nr. 3 të Bordit Drejtues të Qendrës : “Qëndresa Qytetare” me anë të të cilit rezulton të jetë vendosur :
 - “1. Të pranohet dorëheqjen nga Bordi Drejtues të znj. Ines Mulellari dhe z. Altin Çollaku në mbarim të mandatit të tyre dhe me vullnetin dhe zëvendësimin e tyre nga znj. Ogerta Ujkashi dhe znj. Kujtime Kotorri.
 - 2. Bordi i ri Drejtues i Qendrës për periudhën 2019 – 2021 të jetë si më poshtë :
 - Drejtor ekzekutiv Rigels Xhemollari.
 - Anëtar i Bordit Drejtues Kujtime Kotorri.
 - Anëtar i Bordit Drejtues Migel Zallemi.
 - Anëtar i Bordit Drejtues Ogerta Ujkashi.
 - Anëtar i Bordit Drejtues Valmira Kosova.
 - 3. Rigels Xhemollari të zgjidhet Drejtor Ekzekutiv me mandat për periudhën 2019 – 2021.
- Ky vendim të depozitohet nga Drejtori Ekzekutiv në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në Regjistrin Tregtar”.
- Urdhërohet Zyra e Regjistrimit të Organizatave Jo Fitimprurëse të bëjë shënimet përkatëse në regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Kundër vendimit nuk lejohet ankim.
- U shpall në Tiranë sot më datë 22.07.2019.

GJYQATAR

NERITAN ÇENA





I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane, sot me daten 31. 01. 2022, une gjyqtari i Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane Ervin Pollozhani pasi studiova kerkesen dhe materialet e paraqitura nga z. Rigels Xhemollari, me cilesine e Drejtorit Ekzekutiv te Qendres « Qendresa Qytetare »,

KONSTATOVA:

Se, Qendra « Qendresa Qytetare », është regjistruar si person juridik me Vendimin Nr. 1120 dt. 15. 09. 2016 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Ne vijimesi te veprimtarise se saj, ka rezultuar se qendra « Qendresa Qytetare » ka thirrur Mbledhjen e Bordit te Drejtoreve te saj per zhvillimin e nje mbledhje me rend dite *riformatimi i Bordit te Drejtoreve dhe rizgjedhjen e Drejtorit Ekzekutiv te saj.*

Per kete shkak Bordi i Drejtoreve ne perputhje me aktin e themelimit dhe te statutit te qendres si dhe ne vijim te vendimeve te meparshme te marra prej tij, me vendimin Nr. 4 dt. 10. 01. 2022, me vendimmarrjen unanime te anetareve prezent te saj, tre anetare te Bordit, ka vendosur :

1. Te pranoje doreheqjen nga Bordi Drejtues te zj. Ogerta Ujkashi dhe z. Rigels Xhemollari dhe zevendesimin e tyre nga zj. Amina Sinaj dhe z. Fatjon Biba.
2. Bordi Drejtues i Qendres per periudhen 2022-2024 te jete si me poshte :
 - Anetar i Bordit Drejtues Kujtime Kotorri
 - Anetar i Bordit Drejtues Migel Zallemi
 - Anetar i Bordit Drejtues Amina Sinaj
 - Anetar i Bordit Drejtues Fatjon Biba
 - Anetar i Bordit Drejtues Valmira Kosova
3. Rigels Xhemollari te zgjidhet Drejtor Ekzekutiv me mandat per periudhen 2022-2024.
4. Autorizohet Drejtori Ekzekutiv te pasqyroje ndryshimet e mesiperme ne aktet e qendres.

Pikerisht kete vendim te marre, te pasqyruar formalisht, perfaqesuesi i qendres, kerkon qe ta depozitoje prane regjistrimit te OJF-ve me qellim dhenien e efekteve ligjore te tij.

Pasi studiova kerkesen dhe vendimin e siperpermendur si dhe praktiken e akteve te regjistrimit dhe depozitimeve te ndryshme te kesaj qendre, gjykata e gjeti kete kerkese te saj te drejte, te bazuar ne ligj dhe ne statut, dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE :

Ne baze te Ligjit Nr. 8788 date 07. 05. 2001 dhe Ligjit Nr. 8789 date 07. 05. 2001 si dhe dispozitave te Kodit Civil,

VENDOSA :

- Pranimin e kerkeses.
- Depozitimim e Vendimit Nr. 4 dt. 10. 01. 2022 te Bordit Drejtues te Qendres « Qendresa Qytetare », ne Rregjistrin e Organizatave Jo-fitimprurese, me te cilin eshte vendosur:

1. Te pranoje doreheqjen nga Bordi Drejtues te zj. Ogerta Ujkashi dhe z. Rigels Xhemollari dhe zevendesimin e tyre nga zj. Amina Sinaj dhe z. Fatjon Biba.
2. Bordi Drejtues i Qendres per periudhen 2022-2024 te jete si me poshte :
 - Anetar i Bordit Drejtues Kujtime Kotorri
 - Anetar i Bordit Drejtues Migel Zallemi
 - Anetar i Bordit Drejtues Amina Sinaj
 - Anetar i Bordit Drejtues Fatjon Biba
 - Anetar i Bordit Drejtues Valmira Kosova
3. Rigels Xhemollari te zgjidhet Drejtor Ekzekutiv me mandat per periudhen 2022-2024.
4. Autorizohet Drejtori Ekzekutiv te pasqyroje ndryshimet e mesiperme ne aktet e qendres.

-Urdherohet, Zyra e Regjistrimit të OJF-ve pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të kryej veprimet përkatëse për regjistrimin e këtij vendimi.

- Tirane me dt. 31. 01. 2022 !

GJYQTARI

ERVIN POLLOZHANI



Tabela e shpenzimeve

| | |
|--------------------------|-------------------|
| Taksë regjistrimi | 1. 000 lek |
| Totali | 1. 000 lek |